



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 13356 Prot.

Fier, më 21.11.2025

PROJEKT VENDIM
Nr. 105, datë 21.11.2025

PËR DHËNIE NDIHME SHTETËRORE FINANCIARE

Për trajtimin me ndihmë shtetërore financiare të familjes së shtetasit Mateo Çepele, lagjja "Apollonia", Njësia Administrative nr.4, si dhe qeramarrëses së banesës së Tij Znj.Drilona Guri, dëmtuar nga zjarri i datës 05.10.2025.

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar, nenit 30 dhe 41 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr.139, datë 23.12.2024 "*Për miratimin e buxhetit të vitit 2025*" si dhe në zbatim të shkronjave "e" dhe "ë" të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 05.10.2025, shkresave zyrtare nr.1043/1.prot dhe nr.1044/1.prot datë 05.11.2025 "*Vlerësim dëmi*" të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Mateo Çepele ku jetonte me qera shtetësja Drilona Guri dëmi në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake për këtë shtetase është në vlerën **112 000 (njëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë** dhe për shtetasin Mateo Çepele dëmi në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën **60 500 (gjashtëdhjetë mijë e pesëqind) lekë** dhe në anën ndërtimore në vlerën **446 909 (katërqind e dyzetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntë) lekë**, ndaj bazuar në nenin 30, shkronja "gj", e ligjit 45/2019, Drejtoria e Mbrojtjes Civile

PROPOZON:

1. Dhënien e ndihmës financiare prej Bashkisë Fier për shtetasen qeramarrëse Drilona Guri në masën **100%**, vetëm për dëmet e shkaktuara në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, sipas Procesverbaleve me nr.11552/2.Prot dhe nr.11552/3.Prot të datës 03.11.2025, shkresave "Vlerësim dëmi", me nr.1043/1.Prot dhe nr.1044/1.Prot, datë 07.11.2025 të Këshillit të Qarkut dhe Deklaratës Noteriale të datës 21.10.2025, në vlerën prej **112 000 (njëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë**.
2. Dhënien e ndihmës financiare prej Bashkisë Fier për shtetasin Mateo Çepele, në masën **100%**, për dëmet e shkaktuara në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej **60 500 (gjashtëdhjetë mijë e pesëqind) lekë**.

3. Dhënien e ndihmës prej Bashkisë Fier në masën **50%**, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej **223 455 (dyqind e njëzetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë) lekë**, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës “ç” “Përcaktimi i ndihmës financiare” e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
4. Vlera totale financiare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Mateo **Çepele** është në masën **283 955 (dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë**.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile si dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile
Nasip BANI

Drejtoria Juridike
Esmeralda KAPLLANAJ

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Pranvera ÇINA

KRYETARI
Armando SUBASHI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËS KRYETAR

Nustret AVDULLA

